

UDHËZIM
Nr.116, datë 12.4.2010

PËR PROCEDURAT E PËRFTIMIT TË SHPËRBLIMIT NGA REGJISTRIMI I FËMIJËVE SIPAS LIGJIT NR.10 129, DATË 11.5.2009 “PËR GJENDJEN CIVILE”

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pika 4 e nenit 41 të ligjit nr.10 129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”,

UDHËZOJ:

1.Nëpunësit e shërbimit të gjendjes civile do të regjistrojnë të gjithë fëmijët e paregjistruar dhe të lindurit pas hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, sipas procedurave ligjore ekzistuese.

2.Për rastet e regjistrimit të lindjeve të ndodhura brenda vendit të cilat deklarohen brenda afatit 60-ditor nga dita e lindjes, nëpunësi i gjendjes civile do të mbajë aktin e lindjes dhe do të pajisë të interesuarin me certifikatë lindje, në të cilën duhet pasqyruar saktë data e lindjes dhe data e mbajtjes së aktit të lindjes.

3.Për rastet e regjistrimit të lindjeve të ndodhura jashtë shtetit, të cilat deklarohen brenda afatit 90-ditor nga dita e lindjes, nëpunësi i gjendjes civile do ta pajisë të interesuarin me certifikatën e lindjes në të cilën do të pasqyrojë saktë datën e lindjes dhe datën e mbajtjes së aktit, kur akti mbahet në këtë zyrë ose datën e regjistrimit në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile për raste kur akti është mbajtur jashtë shtetit.

4.Nëpunësi i zyrës së gjendjes civile, pasi vëren se rasti përmbush kriteret e pikës 2 dhe 3, e pajis të interesuarin me certifikatën e lindjes së fëmijës me shënimin “Për efekt shpërblimi, nga regjistrimi i lindjes brenda afatit ligjor”. Për të gjitha këto raste, zyra e gjendjes civile harton një listë mujore dhe e dërgon në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe një kopje zyrës së financës përkatëse.

5.I interesuari me certifikatën e lindjes duhet të paraqitet në zyrën e financës së bashkisë/njësisë bashkiake/komunës përkatëse, për të tërhequr shumën prej 5000 (pesë mijë) lekë.

6.Punonjësi i ngarkuar nga kryetari i bashkisë/njësisë bashkiake, komunës, pasi administron certifikatën e lindjes me shënimin “Për efekt shpërblimi, nga regjistrimi i lindjes brenda afatit ligjor”, e verifikon me listën e hartuar nga zyra e gjendjes civile, kryen pagesën dhe në fund të çdo muaji harton listën e shtetasve, të cilët kanë përfituar nga ky shpërblim.

7.Brenda datës 5 të muajit pasardhës, kryetari i bashkisë/njësisë bashkiake/komunës, dërgon pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile në Ministrinë e Brendshme kërkesën për fond, të shoqëruar me listën emërore të fëmijëve të regjistruar brenda afatit ligjor dhe që kanë përfituar/do të përfitojnë shpërblimin.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile përgatit pasqyrën përmbledhëse për njësitë shpenzuese që kanë paraqitur kërkesë për fond dhe çdo dy muaj e dërgon pranë Drejtorisë së Politikave Financiare.

9. Drejtoria e Politikave Financiare përgatit praktikën dhe e dërgon menjëherë në Ministrinë e Financës për rialokimin e fondit nga programi i “Gjendjes civile”, për bashkitë/njësitë bashkiake/komunat.

10. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, Drejtoria e Politikave Financiare në Ministrinë e Brendshme dhe bashkitë/njësitë bashkiake/komunat.

11. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I BRENDSHËM
Lulzim Basha